

LIGJ
Nr.9820, datë 25.10.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR ZHVILLIMIN E
BASHKËRENDAR TË AUTOSTRADËS UNAZË TË DETIT TË ZI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Memorandumi i mirëkuptimit për zhvillimin e bashkërenduar të autostradës unazë të Detit të Zi”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5499, datë 1.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Shtojca IV e BS/SOM/R(2006)4
Draft

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
PËR ZHVILLIMIN E BASHKËRENDAR TË AUTOSTRADËS UNAZË TË DETIT TË ZI**

Qeveritë e shteteve anëtare të Organizatës për Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ), këtu të referuara si Palët:

me dëshirën për të forcuar bashkëpunimin e shteteve anëtare të BEDZ-it në promovimin e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe të pasagjerëve, e konsideruar tejet e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të tyre;

duke besuar se një plan i bashkërenduar i rehabilitimit dhe ndërtimit të rrugëve është thelbësor për vendosjen dhe zgjerimin e lidhjeve ndërmjet BE-së, vendeve të Detit të Zi dhe vendeve aziatike dhe nevojitet për të plotësuar kërkesat e trafikut ndërkombëtar në të ardhmen;

duke theksuar se zgjidhja e problemeve të përbashkëta të zhvillimit të bashkërenduar të infrastrukturës rrugore kërkon metoda të reja dhe krijuese, brenda kuadrit të bashkëpunimit rajonal;

duke pasur parasysh se zhvillimi i autostradës unazë të Detit të Zi, këtu i referuar si AUDZ-i, do të nxisë gjithashtu bashkëpunimin në zhvillimin e infrastrukturës multimodale të transportit;

me dëshirën për të pasur interkonjeksione rrugore të mjaftueshme me rrjetet e transportit transeuropian, paneuropian dhe euroaziatik;

duke marrë në konsideratë deklaratën e përbashkët të ministrave të transportit të shteteve anëtare të AUDZ-it mbi lidhjen e rrjetit të transportit të Detit të Zi me rrjetin e transportit transeuropian, brenda kuadrit të lidhjeve të transportit Euroaziatik, të nënshkruar, më 28 janar 2005 në Selanik;

me dëshirën që AUDZ-i të ndërtohet në bashkërendim me BE-në, me qëllim përfshirjen në rrjetin për zgjerim të akseve kryesore të transportit transeuropian të rajoneve dhe vendeve fqinje;

duke pasur parasysh se bashkëpunimi ekonomik duhet të përmbushë nevojat reale dhe interesat e Palëve;

të vetëdijshme se ndërtimi i AUDZ-it përbën një sfidë të rëndësishme për Organizatën e

Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi, organizmat e së cilës janë thirrur për të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe bashkëvepruar për suksesin e projektit;

të vetëdijshme për faktin se zhvillimi i infrastrukturës mbetet një proces afatgjatë;

kanë rënë dakord për memorandumun e mëposhtëm të mirëkuptimit, si një hap drejt objektivit të përbashkët të ndërtimit të autostradës unazë të Detit të Zi.

Neni 1

Qëllimi i memorandumit të mirëkuptimit

1. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Palëve për zhvillimin e autostradës unazë të Detit të Zi (AUDZ), një rrugë ndërkombëtare përqark Detit të Zi, në përputhje me marrëveshjet në fuqi dhe rregulloret dhe standardet përkatëse. Një bashkëpunim i tillë duhet të fokusohet kryesisht në përpunimin e politikave, përfshirë masat dhe parimet e përgjithshme organizative, legjislative dhe ekonomike, si dhe mënyrat e realizimit dhe ndjekjes së tyre.

2. Zhvillimi i AUDZ-it përbën një hap të rëndësishëm drejt krijimit të korridorit unazë të Detit të Zi, një rrjet transporti shumëmodal dhe përfshin mirëmbajtjen, rikonstruksionin, rehabilitimin, përmirësimin dhe rindërtimin e infrastrukturës rrugore kryesore dhe ndihmëse.

3. Sigurimi i asistencës në projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen teknike, operimin dhe menaxhimin e AUDZ-it në territoret e Palëve, brenda kuadrit të infrastrukturës së plotë të transportit europian, duke bërë të mundur në këtë mënyrë ndërtimin e lidhjeve që mungojnë në rrjetin ekzistues të autostradës së rajonit të Detit të Zi.

4. Përcaktimi i parakushteve dhe kushteve për përdorimin sa më efikas të fondeve dhe njohurive të siguruar nga burimet publike dhe private.

5. Përhapja e mëtejshme në rajon e njohurive, përvojës, ekspertizës së akumuluar deri tani në shtetet anëtare të BE-së.

Neni 2

Tiparet kryesore të AUDZ-it

1. AUDZ-i përbën një autostradë me kapacitet të lartë. Komiteti drejtues i AUDZ-it, i krijuar nga neni 3 i këtij memorandumi mirëkuptimi, mund ta shqyrtojë në detaje itinerarin e saktë kryesor të autostradës, lidhjet ndihmëse të saj, si dhe standardet e saj teknike mbi bazën e rekomandimeve dhe normave të miratuara nga organizatat ndërkombëtare dhe BE-së, përfshirë marrëveshjen europiane përkatëse mbi arteriet kryesore të trafikut ndërkombëtar.

2. AUDZ-i siguron shërbime të një cilësie të mjaftueshme për trafikun modern, duke siguruar siguri, shpejtësi dhe komfort dhe në këtë mënyrë ndihmon zhvillimin ekonomik dhe social në interes të të gjithë Kontinentit Europian. Në këtë kontekst, Palët, duke marrë parasysh se pjesët e AUDZ-it janë gjithashtu pjesë e rrjetit transeuropian të transportit, kanë rënë dakord ta promovojnë AUDZ-in pranë autoriteteve kompetente ndërkombëtare, në mënyrë që në të ardhmen të përfshihet në rrjetin për zgjerim të akseve kryesore të transportit transeuropian me rajonet dhe vendet fqinje.

3. Gjatësia e AUDZ-it është afërsisht 7000 km.

Itinerari kryesor dhe lidhjet e tij mund të përfshijnë qytetet e mëposhtme:

Stamboll (Turqi), Samsun (Turqi), Trabzon (Turqi), Batumi (Gjeorgji), Poti (Gjeorgji), Yerevan (Armeni), Baku (Azerbaxhan), Novorossiysk (Rusi), Rostov-on-Don (Rusi), Taganrog (Rusi), Mariupol (Ukrainë), Melitopol (Ukrainë), Odessa (Ukrainë), Chisinau (Moldavi), Bukuresht (Rumani), Kostanca (Rumani), Haskovo (Bullgari), Sofie (Bullgari), Nish (Serbi), Beograd (Serbi), Tirana (Shqipëri), Edirne (Turqi), Komotini (Greqi), Aleksandropulis (Greqi).

4. Komiteti drejtues i AUDZ-it do të përpunojë itinerarin kryesor dhe lidhjet e tij në një fazë të mëvonshme.

Neni 3

Masat organizative për realizimin e AUDZ-it

1. Për zbatimin e projektit të AUDZ-it, Palët bien dakord të vendosin që sesionet e komitetit drejtues të AUDZ-it të mbahen të paktën një herë në vit, menjëherë para ose pas sesionit të grupit të

punës së AUDZ-it mbi transportin. Komiteti drejtues i AUDZ-it formulon politikën e zhvillimit të AUDZ-it dhe vendos mbi të gjitha masat përkatëse për realizimin e saj.

2. Secila Palë dhe Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi PERMIS përfaqësohen në komitetin drejtues të AUDZ-it dhe emërojnë një përfaqësues së bashku me zëvendësuesin e tij/saj. Përfaqësues të tillë mund të përkujnë me ata persona që marrin pjesë në grupin e punës së AUDZ-it mbi transportin. Palët bien dakord të ftojnë BSTDB-në për të marrë pjesë plotësisht në komitetin drejtues të AUDZ-it. Komiteti drejtues i AUDZ-it merr vendimet e tij me konsensus, duke respektuar rregullat e procedurës, të cilat ai i miraton. Anglishtja mbetet gjuha e punës e komitetit drejtues të AUDZ-it. Palët kryesojnë me radhë komitetin drejtues për dy vjet sipas renditjes së përcaktuar në shtojcën I, e cila përbën një pjesë përbërëse të memorandumit të mirëkuptimit. Kryesimi ushtrohet nga çdo shtet anëtar i AUDZ-it, sipas kalendarit të përcaktuar. Nënkyesia ushtrohet nga çdo shtet anëtar i AUDZ-it, i cili do të marrë kryesinë e radhës.

3. Përfaqësues të vëzhguesve të AUDZ-it, organet që kanë lidhje me AUDZ-in, partnerët rajonalë të dialogut të AUDZ-it dhe organizata e institucione të tjera ndërkombëtare të interesuara mund të ftohen në sesionet e komitetit drejtues të AUDZ-it, kur çmohet e nevojshme.

4. Palët bien dakord gjithashtu të krijojnë një sekretariat teknik të përhershëm të përbashkët, detyra e të cilit është të mbështesë punimet e komitetit drejtues të AUDZ-it dhe të procedojë me çdo veprim të nevojshëm mbi bazën e udhëzimeve të vendosura nga komiteti drejtues i AUDZ-it për implementimin e autostradës. Më specifikisht, sekretariati teknik i përhershëm i përbashkët paraqet propozime, vlerëson studimet dhe bashkëpunon me komitetin drejtues të AUDZ-it për identifikimin e burimeve financiare.

5. Në secilin vend të Palëve, emërohet një koordinator kombëtar për AUDZ-in nga qeveria e vendit përkatës. Koordinatori është përgjegjës për koordinimin e çdo aktiviteti të realizuar në vend për sa i përket AUDZ-it. Koordinatori mund të përkujë me përfaqësuesin e lartpërmendur ose zëvendësuesin e tij në komitetin drejtues të AUDZ-it.

6. Financimi i masave administrative, organizative dhe teknike realizohet nga fondi i projektit për bashkëpunimin për qëllime të veçanta të AUDZ-it, i krijuar sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare të veçantë ndërmjet Palëve, ku përcaktohen objektivat, detyrat, metodat dhe procedurat e menaxhimit të fondit.

Neni 4 **Financimi i AUDZ-it**

Sekretariati teknik i përhershëm i përbashkët krijohet në Selanik dhe Republika Greke mbulon të gjitha shpenzimet përkatëse.

Financimi i ndërtimit dhe rindërtimit të AUDZ-it realizohet prej fondeve dhe buxheteve kombëtare, si dhe prej kapitaleve të ndryshme që burojnë nga sektori privat. Financimi, gjithashtu mund të sigurohet nëpërmjet fondeve dhe huave të BE-së, me anë të Bankës Europiane për Investim, Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Bankës Botërore dhe bankave dhe fondeve të tjera.

Neni 5 **Procedura për amendimin e memorandumit të mirëkuptimit**

1. Amendimet mund të realizohen në memorandumin e mirëkuptimit, në përputhje me çdo procedurë të paraqitur në këtë dokument:

a) me kërkesë të çdo Pale, propozimi për amendim shqyrtohet nga ana e grupit të punës së transportit të AUDZ-it;

b) në rastet kur amendimi miratohet me një shumicë prej 2/3 të pjesëmarrësve në votim dhe nëse një shumicë e tillë përbën 2/3 e Palëve të përfaqësuara dhe pjesëmarrëse në votim, atëherë sekretari i përgjithshëm i AUDZ PERMIS ua paraqet amendimet të gjitha Palëve për miratim;

c) nëse shumica prej 2/3 e Palëve e miraton amendimin, atëherë AUDZ PERMIS njofton të gjitha Palët për këtë dhe amendimi hyn në fuqi me skadimin e 12 muajve nga data e njoftimit. Amendimi hyn në fuqi për të gjitha Palët.

2. Me kërkesë e të paktën 1/3 e Palëve, sekretari i përgjithshëm i AUDZ PERMIS mban një konferencë në të cilën ftohen shtetet anëtare të AUDZ-it. Procedura e përcaktuar në nënparagrafin (a) dhe (b) të paragrafit (1) në këtë dokument zbatohet për sa i përket çdo propozimi të paraqitur për

ndryshim nga konferenca.

Neni 6

Komunikimi i adresës së administratës

Secila Palë, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, aprovimit dhe miratimit të këtij Memorandumi ose të aderimit në të, informon sekretarin e përgjithshëm të AUDZ-it mbi emrin e administratës dhe adresën në të cilën propozimet për ndryshim duhet të dërgohen sipas nenit 4 dhe 5 të këtij Memorandumi.

Neni 7

Hyrja në fuqi e memorandumit të mirëkuptimit

Ky memorandum hyn në fuqi ditën e parë të muajit, pasi tetë palë ta kenë nënshkruar dhe të jetë njoftuar AUDZ-i PERMIS se Palët kanë plotësuar procedurat ligjore që nevojiten për këtë qëllim.

Neni 8

Kohëzgjatja

Ky memorandum mbetet në fuqi për një afat kohor fillestar prej dhjetë vitesh dhe pas mbarimit të kësaj periudhe automatikisht rinovohet për periudha të njëpasnjëshme pesëvjeçare, me përjashtim të rasteve kur i jepet fund me njoftim me anë të 2/3 të Palëve. Vërejtjet e tyre/Palëve duhet të paraqiten jo më vonë se një vit para skadimit të periudhës dhjetëvjeçare.

Neni 9

Prishja dhe mbarimi i memorandumit

1. Originali i këtij memorandum, i hartuar në një kopje në gjuhën angleze, ruhet nga ana e Sekretariatit të Përhershëm Ndërkombëtar (PERMIS), i cili do t'i dorëzojë çdo Palë një kopje të autorizuar/vërtetuar dhe do t'i realizojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga roli i tij si depozitar.

2. Qeveritë e shteteve anëtare të AUDZ-it, të cilat nuk e kanë nënshkruar këtë memorandum, mund të bëhen palë e këtij dokumenti, vetëm pasi ai të ketë hyrë në fuqi.

3. Qeveritë, të cilat e kanë nënshkruar këtë memorandum, pasi ai të ketë hyrë në fuqi, mund të bëhen palë ditën e tridhjetë, pasi t'i jetë kaluar depozitarit një njoftim mbi plotësimin e të gjitha procedurave kombëtare të zbatueshme para hyrjes në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare.

4. Secila Palë mund t'i jap fund këtij memorandum, duke paraqitur një njoftim me shkrim pranë sekretarit të përgjithshëm të AUDZ-it.

5. Ky memorandum bëhet i pavlefshëm, nëse numri i Palëve që e kanë nënshkruar atë, është më pak se katër brenda çdo periudhe të dymbëdhjetë muajve.

SHTOJCA I

SKEMA E ROTACIONIT TË PROPOZUAR MBI KRYESINË/NËNKRYESINË E KOMITETIT DREJTUES

Presidenti	Zëvendëspresidenti
Federata Ruse	Republika e Bullgarisë
Republika e Bullgarisë	Ukraina
Ukraina	Gjeorgjia
Gjeorgjia	Republika e Turqisë
Republika e Turqisë	Republika e Azerbajxhanit
Republika e Azerbajxhanit	Republika e Greqisë
Republika e Greqisë	Republika e Shqipërisë
Republika e Shqipërisë	Republika e Moldavisë
Republika e Moldavisë	Republika e Armenisë
Republika e Armenisë	Republika e Serbisë

Republika e Serbisë	Rumania
Rumania	Federata Ruse